

# Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës

Metadata Referenciale në format ESS Standard for Quality Reports  
Structure (ESQRS)

INSTAT

## Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Paraqitura statistikore.....	2
3. Përpunimi statistikor .....	5
4. Manaxhimi i cilësisë .....	7
5. Rëndësia .....	8
6. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
7. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	11
8. Koherenca dhe krahasueshmëria.....	12
9. Aksesi në të dhëna dhe qartësia .....	13
10. Kostoja dhe ngarkesa .....	14
11. Konfidencialiteti .....	14
12. Komente .....	15
Aneks .....	15

<b>1. Kontakt</b>	
1.1 Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Nivelit të Jetesës, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Blerta Muja
1.4. Funksioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Sektori i Nivelit të Jetesës
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:bmuja@instat.gov.al">bmuja@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+355 2233357
1.8. Numri i faksit	+355 4 228300
<b>2. Paraqitura statistikore</b>	
2.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Anketa mbi prodhimin e statistikave evropiane mbi të ardhurat dhe nivelin e jetesës (EU-SILC) u realizua për herë të parë në Shqipëri në vitin 2017 dhe është realizuar në baza vjetore. Kjo anketë është burimi kryesor i statistikave kombëtare për shpërndarjen e të ardhurave, varférinë dhe përjashtimin social.</p> <p>EU-SILC realizohet sipas Rregullores Evropiane (KE) Nr. 1177/2003, e cila përcakton rregullat me të cilat kryhet kjo anketë në një mënyrë të harmonizuar në nivel European.</p> <p>Grumbullimi i të dhënave koordinohet gjithashtu nga Eurostat i cili ofron udhëzime metodologjike me anë të të cilave kjo anketë mund të kryhet në standarde më të larta të cilësisë. Informacioni i mbledhur nga kjo anketë përfshin të dhëna në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave të familjes, shëndetin dhe aftësinë e kufizuar, punësimin dhe privimin material.</p> <p>Në këtë kontekst, treguesit e nxjerrë nga SILC synojnë të identifikojnë kategoritë e popullsisë që janë më të prirura ndaj varférisë dhe privimit material.</p> <p>Metoda e përdorur për realizimin e SILC përfshin intervista personale në një kampion përfaqësues familjesh duke përdorur teknikën CAPI (Intervistë Personale e Asistuar me Kompjuter).</p> <p>SILC është një anketë panel, e dizenuar me rotacione. Kampioni për çdo vit përbëhet nga 4 grupe rotacioni, të cilat kanë qenë në studim për 1-4 vjet. Me përjashtim të tre viteve të para të studimit, çdo grup rotacioni mbetet në studim për 4 vjet. Çdo vit, njëri nga 4 grupet e rotacionit nga viti i kaluar bie dhe shtohet një i ri, kjo skemë rotacioni ka filluar nga viti 2017.</p> <p>Kjo metodologji bën të mundur që INSTAT të analizojë më saktë ndryshimet në të ardhurat dhe situatën socio-ekonomike të familjeve për një periudhë relativisht të gjatë, periudhë 4 vjeçare.</p>

2.2. Sistemi i klasifikimit	<p>SILC ndjek standardet ndërkombe të lidhje me klasifikimin: ISCO, NACE, ISCED dhe Shkalla e Urbanizimit.</p> <p>Klasifikimet kryesore të përdorura janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <a href="#">ISCED 2011</a> për nivelin e arsimit,</li> <li>2. <a href="#">ISCO 08</a> për profesion dhe</li> <li>3. <a href="#">NVE Rev.2</a> për aktivitetin ekonomik.</li> </ol>
2.3. Mbulimi i sektorit	<p>Kampioni përfshin të gjithë territorin e Shqipërisë. Kampioni përfaqëson të gjithë popullsinë. Popullsia që jeton në banesa kolektive si: jetimoret, konviktet, shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë për fëmijët me aftësi të kufizuara, hotelet, kazermat e ushtarëve, spitalet, sanatoriumet, institucionet e burgimit nuk përfshihen në këtë studim.</p>
2.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Sipas metodologjisë për matjen e varfërisë, linja e varfërisë llogaritet bazuar në konceptin e saj relativ (i varfér në raport me të tjerët) dhe përcaktohet në 60% të medianës së të ardhurave të disponueshme të ekuivalentuara të familjes, duke përdorur shkallën e modifikuar të ekuivalentuar të OECD. <b>Linja e varfërisë</b> përfaqëson të ardhurat më të ulëta vjetore të disponueshme që një person nuk do të konsiderohej në rrezik për të qenë i varfér.</p> <p>Të ardhurat totale të disponueshme të ekuivalentuara të familjes konsiderohen të ardhurat totale neto (domethënë të ardhurat pas taksave dhe kontributeve shoqërore) të marra nga të gjithë anëtarët e familjes.</p> <p><b>Koncepti i njësisë ekonomike familjare (NjEF):</b> i referohet një grapi njerëzish, që kanë lidhje gjaku ose jo, të cilët jetojnë së bashku në të njëjtën banesë ose në një pjesë të saj dhe ndajnë një ekonomi plotësisht ose pjesërisht të përbashkët.</p> <p><b>Të ardhurat e ekuivalentuara:</b> Të ardhura të disponueshme të ekuivalentuara të individit konsiderohen të ardhurat totale të disponueshme të NjEF pasi janë ndarë me madhësinë ekuivalente të NjEF. Në shpërndarjen e të ardhurave për person, secili anëtar i familjes ka të njëjtën sasi të ardhurash, që korrespondon me të ardhurat ekuivalente të disponueshme të NjEF. Kjo do të thotë që secili anëtar i familjes gëzon të njëjtin nivel jetese. Si pasojë, në shpërndarjen e të ardhurave për person, të ardhurat që i atribuohen secilit person nuk përfaqësojnë pagat, por në të vërtetë, një tregues të nivelit të jetesës.</p> <p><b>Shkalla ekuivalente:</b> Madhësia ekuivalente i referohet shkallës së modifikuar të OECD-së e cila i jep peshën 1.0 të rriturit të parë (mbi 14 vjeç), 0.5 për personat e tjerë të moshës 14 vjeç ose më shumë që jetojnë në familje dhe 0.3 për secilin fëmijë të moshës nën 14 vjeç.</p> <p><b>Shkalla e rrezikut për të qenë i varfér</b> tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme ekuivalente janë nën kufirin e rrezikut të varfërisë (pragu i varfërisë).</p> <p><b>Privimi material</b> tregon nivelin e jetesës së popullsisë nga shkalla e privimit material, ose përqindja e personave të privuar materialisht.</p> <p><b>Personat</b> thellësishet të privuar materialisht janë ata që jetojnë në familje të cilët nuk mund të përballojnë të paktën katër nga nëntë kategoritë e privimit material në lidhje me pasuritë, kushtet e jetesës ose aspektet financiare.</p>

	<p>Nëntë kategoritë e privimit material janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pagesat e prapambetura të kësteve të kredisë për banesën kryesore ose pagesave të qirasë, faturat e shërbimeve, këstet e blerjeve me kredi ose pagesa të tjera të huasë;</li> <li>2. Mundësia financiare për të përballuar pagimin e një jave pushimi vjetor larg shtëpisë;</li> <li>3. Mundësia financiare për të përballuar një vakt me mish, pulë, peshk (ose ekuivalentin me vegetarjan) çdo dy ditë;</li> <li>4. Mundësia financiare për të përballuar shpenzime të papritura por të domosdoshme prej 30.000 lekësh;</li> <li>5. Mundësia financiare për të përballuar një telefon (përfshirë telefonin celular);</li> <li>6. Mundësia financiare për të përballuar një TV me ngjyra;</li> <li>7. Mundësia financiare për të përballuar një makinë larëse;</li> <li>8. Mundësia financiare për të përballuar një makinë dhe</li> <li>9. Mundësia financiare për të përballuar mbajtjen e shtëpisë të ngrohtë në mënyrë të përshtatshme.</li> </ol> <p><b>Intensiteti i punës</b> në NjEF përcaktohet si raport i numrit të muajve që të gjithë anëtarët e NjEF kanë punuar gjatë vitit referues të të ardhurave me numrin e përgjithshëm të muajve që teorikisht mund të kishin punuar gjatë së njëjtës periudhë. Një person konsiderohet ekonomikisht aktiv kur ai / ajo është 18-59 vjeç duke përashtuar njerëzit që varen nga NjEF dhe i përkasin grumoshës 18-24 vjeç.</p> <p><b>Intensiteti shumë i ulët në punësim</b> i referohet situatës së personave në NjEF ku asnjëri nuk punon, ose punojnë shumë pak, që do të thotë se anëtarët e NjEF në moshë pune punojnë vetëm 20% ose më pak të numrit të përgjithshëm të muajve që mund të punojnë gjatë periudhës së references.</p>
2.5. Njësia statistikore	<p>Njësitë Ekonomike Familjare dhe personat pjesw e një NjEF private.</p> <p>Baza e marrjes së kampionit për grupin e e ri të NjEF të zgjedhura për vitin 2019, për të dy fazat, ishte e dhëna e Censit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. PSU quhen segmente. Segmentet janë zona të cilat përbajnjë nga 120 familje sipas Censit 2011. Janë krijuar nga një ose më shumë zona numërimi të quajtura Startum, të përdorura në Censin 2011 dhe që i përkasin të njëjtës Bashki.</p> <p>Në secilën Startum PSU-të u zgjodhën në mënyrë sistematike me probabilitet proporcional me madhësinë (masa e madhësisë ishte numri i familjeve në PSU), dhe në fazën e dytë u zgjodhën 12 adresa (banesa të banuara) në secilën PSU të zgjedhur. Të gjitha familjet në adresat e zgjedhura ndërtojnë një kampion familjesh.</p>
2.6. Popullata statistikore	<p>Popullsia referuese e EU-SILC janë të gjitha NjEF private dhe anëtarët e tyre aktualë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë në kohën e mbledhjes së të dhënave.</p> <p>Personat që jetojnë në banesa kolektive dhe në institucione përashtohen nga popullata e synuar.</p> <p>Nuk ka dallime midis konceptit kombëtar dhe standardit EU-SILC.</p>

2.7. Zona e referencës	Të dhënata për SILC mbulojnë të gjithë territorin e vendit dhe në nivel qarku.										
2.8. Mbulimi në kohë	Mbulimi i të dhënave SILC ka filluar që nga viti 2017, si viti i parë i anketës.										
2.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.										
<b>3. Përpunimi statistikor</b>											
3.1. Burimi i të dhënave	<p>Lidhur me implementimin e SILC, tre përkufizime të ndryshme në lidhje me madhësinë e kampionit janë aplikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Madhësia aktuale e kampionit e cila është numri i njësive të zgjedhura në kampion.</li> <li>- Madhësia e arritur e kampionit e cila është numri i njësive të vëzhguara të kampionimit (familje ose individ) me një intervistë të pranuar.</li> <li>- Madhësia efektive e mostrës e cila përcaktohet si madhësia e arritur e kampionit e ndarë nga efekti i dizenjimit në lidhje me treguesin e rrezikut për të qenë I varfër.</li> </ul> <p>Për të dhënata e SILC 2019, INSTAT ndjek në mënyrë rigorozë kërkesat e përcaktuara për madhësinë minimale efektive të madhësisë së kampionit siç specifikohet në rregulloren Europiane të SILC 1177/2003.</p> <p>Lidhur me informacionin në lidhje me madhësinë minimale efektive të kampionit Shqipëria ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• NjEF - që i përkasin një viti- Cross-sectional: 4200 NjEF.</li> <li>• NjEF - panel që përsëriten nga viti në vit- Longitudinal: 3000 NjEF.</li> <li>• Personat e moshës 16+ Cross-sectional: 11000 individë.</li> <li>• Personat e moshës 16+ Longitudinal: 8000 individë.</li> </ul> <p>Kampioni panel (longitudinal) ndiqet me kalimin e kohës në përputhje me rregullat e specifikuara në rregulloren e zbatimit të BE-SILC 1982/2003.</p> <p>Baza e të dhënave e bazuar në Censusin e Popullsisë dhe Banesave 2011, ofron një numër të plotë të të gjithë personave që jetojnë në Shqipëri.</p> <p>Si rezultat, kjo bazë e të dhënave konsiderohet të jetë burimi më i përshtatshëm që do të përdoret për zgjedhjen e kampionit të SILC dhe shërben si kornizë e marrjes së kampionit, nga e cila u zgjodhën gjithsej 8380 familje për kampionin SILC 2019.</p> <p>Në këtë pjesë vëmendja përqendrohet kryesisht në madhësinë e arritur të kampionit.</p> <p>Madhësia e arritur e kampionit për SILC 2019 në Shqipëri është:</p> <table style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th><b>Rotacioni 1</b></th> <th><b>Rotacioni 2</b></th> <th><b>Rotacioni 3</b></th> <th><b>Rotacioni 4</b></th> <th><b>Kampioni gjithsej i arritur (familje)</b></th> </tr> <tr> <td>1389</td> <td>2052</td> <td>2295</td> <td>1270</td> <td>7006</td> </tr> </table>	<b>Rotacioni 1</b>	<b>Rotacioni 2</b>	<b>Rotacioni 3</b>	<b>Rotacioni 4</b>	<b>Kampioni gjithsej i arritur (familje)</b>	1389	2052	2295	1270	7006
<b>Rotacioni 1</b>	<b>Rotacioni 2</b>	<b>Rotacioni 3</b>	<b>Rotacioni 4</b>	<b>Kampioni gjithsej i arritur (familje)</b>							
1389	2052	2295	1270	7006							

3.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	<p>Frekuencia e mbledhjes së të dhënave bëhet në baza vjetore. Shqipëria duke filluar nga viti 2017 mbledh të dhëna në bazë vjetore.</p> <p>Grumbullimi i të dhënave u realizua gjatë periudhës Prill–Korrik 2019. Periudha referuese e të ardhurave për EU-SILC 2019 ishte viti kalendarik 2018.</p>						
3.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Puna për procesin e mbledhjes së të dhënave për vitin N fillon në fund të vitit N-1. Pjetësori i ri (duke përfshirë të gjitha ndryshimet vjetore dhe përditësimet) dhe versioni i përditësuar i programit CAPI janë realizuar. Në fillim të vitit N, programi testohet plotësisht dhe anketuesit zgjidhen dhe informohen në përputhje me kushtet. Gjithashtu, në atë kohë nxirret kampioni i familjeve të reja. Pas përfundimit të procedurave të testimt, anketuesit informohen për pyetësorët në letër dhe kompjuter. Periudha e mbledhjes së të dhënave zgjat afersisht 4 muaj të të njëjtë vit N.</p> <p><b>Mënyra e mbledhjes së të dhënave</b></p> <p>Metoda e mbledhjes së të dhënave në Shqipëri është përmes intervistave ballë për ballë përmes sistemit CAPI. Më poshtë paraqitet shpërndarja për llojin e realizimit të intervistave në SILC 2019:</p> <table border="1" data-bbox="430 848 1017 974"> <thead> <tr> <th colspan="2" data-bbox="430 848 1017 884">2019</th> </tr> <tr> <th data-bbox="509 884 668 916">2-CAPI</th><th data-bbox="747 884 970 916">7- CAPI me proxy</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="509 929 668 961">60.86</td><td data-bbox="811 929 890 961">39.14</td></tr> </tbody> </table> <p><b>Intervistë me proxy</b> (mbledhja e informacionit të individit nga një person tjeter dhe jo nga vetë individi).</p> <p>Në përgjithësi, 39.14% e të gjitha intervistave personale u kryen nga intervista me proxy nga një anëtar tjeter i familjes. Qëllimi ynë ishte të mbanim normën e ulët të realizimit të intervistave proxy (me përfaqësues), por kryesisht të arrijmë një shkallë sa më të lartë të përgjigjes.</p> <p><b>Kohëzgjatja mesatare e intervistës</b></p> <p>Kohëzgjatja mesatare e intervistës përfamilje llogaritet si shuma e kohëzgjatjes së të gjitha intervistave në familje plus shuma e kohëzgjatjes së të gjitha intervistave personale, pjesëtuar me numrin e pyetësorëve të plotësuar të familjeve. Vetëm familjet e pranuara për bazën e të dhënave duhet të merren parasysh.</p> <p>Kohëzgjatja mesatare e intervistës 2019 = 38 minuta.</p>	2019		2-CAPI	7- CAPI me proxy	60.86	39.14
2019							
2-CAPI	7- CAPI me proxy						
60.86	39.14						
3.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Një numër i proceseve të punës janë kryer gjatë mbledhjes së të dhënave në mënyrë që të sigurohet që të dhënat janë mbledhur në mënyrën e duhur. Masat që zbatohen rregullisht përfshijnë: kontolle në pyetësorë, kontolle të anketuesve, ndjekje të familjeve që nuk përgjigjen, etj. Në procesin e futjes së të dhënave, sistemi i futjes së të dhënave (CAPI) ka të implementuar kontolle logjike.</p> <p>Baza e të dhënave SILC validohet më tej përmes një numri rregullash kontrolli gjatë fazës së analizës. Pas përpunimit të të dhënave primare dhe realizimit të ndryshimeve të synuara, kryhet verifikimi me programin SAS të siguruar nga Eurostat për verifikimin dhe validimin e të dhënave. Kontolle shtesë që lidhen</p>						

	me përputhshmërisë kryhen para publikimit të informacionit.
3.5. Përpilimi i të dhënave	Imputimi normalisht bëhet duke përdorur informacionin tashmë ekzistues në përputhje me përdorimin e disa metodave. Për të përgjigjurit që marrin pjesë për herë të dytë, të tretë ose të katërt, imputimi bëhet duke përdorur të dhëna të mbledhura nga vitet e mëparshme. Kjo metodë preferohet pasi siguron përputhshmëri me të dhënat e viteve të mëparshme. Kur merren parasysh të anketuarit e rinj ose kur informacioni nga vitet e mëparshme nuk është i disponueshëm, përdoret informacioni nga persona të tjera ose familje me karakteristika të ngjashme. Në rastet kur këto dy metoda nuk janë të mundshme, përdoren metoda matematikore të imputimit, siç janë teknikat e bazuara në regresion.
3.6. Rregullimi	Të dhënat e munguara imputohen duke përdorur procedurat e specifikuara në rregulloren zbatuese të SILC 1981/2003. Kjo përfshin të dhëna për të ardhurat, përbërjen e familjes dhe elementë të tjera.  Për më tepër, të dhënat peshohen për të korrigjuar njësitë të cilat nuk janë përgjigjur dhe prishjen e panelit dhe më pas kalibrohen në mënyrë që të pasqyrojnë karakteristikat e popullatës së synuar.  Rregullimi sezonal nuk aplikohet.
<b>4. Manaxhimi i cilësisë</b>	
4.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar të sigurojë cilësinë më të lartë në lidhje me përpilimin e statistikave zyrtare. Në përputhje me "Ligjin për Statistikat Zyrtare", Nr.17 / 2018, datë 17.04.2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të njoitura ndërkombëtarisht dhe kryen analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe sigurimin e statistikave sa më të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane. INSTAT deklaron se merr parasysh parimet e mëposhtme: paanshmërinë, cilësinë e proceseve dhe produkteve, orientimin e përdoruesit, orientimin e punonjësve, efektivitetin e proceseve statistikore, zvogëlimin e ngarkesës së punës për të përgjigjurit.
4.2. Vlerësimi i cilësisë	Manuali metodologjik doc065 i siguruar nga Eurostat është referencë e vazhdueshme për të siguruar përputhjen e plotë me përkufizimet e Eurostat.  Të gjitha metodat janë të dokumentuara në këtë raport cilësie i cili përditësohet çdo vit.  INSTAT pranon që prodhimi i statistikave me cilësi të lartë nga SILC është thelbësor për qëllimet e politikëbërjes. Gjatë viteve të kaluara, u bënë shumë përpjekje për të siguruar saktësinë e rezultateve. Rëndësi të madhe i është dhënë edhe prodhimit të rezultateve të harmonizuara. Në këtë drejtim, është bërë çdo përpjekje për të siguruar që të gjitha rekomandimet e Eurostat dhe të gjitha kërkesat e Rregullores të respektohen në mënyrë rigorozë.

## 5. Rëndësia

5.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e SILC klasifikohen si përdorues të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>Përdoruesit e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucionet qeveritare</li> <li>• Universitetet</li> <li>• Organizata joftimprurëse kombëtare dhe ndërkombejtare</li> <li>• Bizneset</li> <li>• Studiuesit, studentët dhe grupe të tjera të ngjashme.</li> </ul> <p>Përdoruesit e brendshëm janë sektorë të tjerë brenda INSTAT që përdorin rezultatet e SILC si input për punën e tyre si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarisë Kombëtare;</li> <li>• Sektori i Metodologjisë;</li> <li>• Sektori i Statistikave të Çmimeve;</li> <li>• Drejtoria Rajonale e Statistikave;</li> <li>• Drejtoria e Statistikave Sociale;</li> <li>• Zyrat Rajonale të Statistikave.</li> </ul>
5.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Gjatë vitit 2020, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Rezultatet e vrojtit tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës" është vlerësuar me 3.61 (72.2%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) deri në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
5.3. Plotshmëria	<p>Shkalla në të cilën janë në dispozicion të gjitha statistikat që nevojiten. Të gjitha informacionet e nevojshme janë mbledhur dhe përpiluar për Eurostat. Një informacion i tillë mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Eurostat: <a href="http://ec.europa.eu/eurostat/data/database">http://ec.europa.eu/eurostat/data/database</a>.</p>
5.3.1. Plotshmëria e të dhënavë - shkalla e plotshmërisë së të dhënavë	<p>Shkalla e plotësisë së të dhënavë, për SILC 2019 është pothuajse 100%. Kjo përllogaritje mori parasysh Rregulloren 1177/2003 dhe shprehet si raport i numrit të variablate të mbledhur nga INSTAT dhe numrit të variablate të kërkuar nga EUROSTAT.</p>
<h2>6. Saktësia dhe besueshmëria</h2>	
6.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Për sa i përket kërkesave të saktësisë, rregullorja EU-SILC si dhe rregullorja e Komisionit mbi rregullat e hartimit të kampionit dhe gjurmimit i referohet përkatesisht, madhësisë efektive të kampionit që duhet të arrihet dhe përfaqësimit të kampionit. Madhësia efektive e kampionit kombinon madhësinë e kampionit dhe efektin e disenjimit të kampionit i cili varet nga disenjimi i kampionit, struktura e popullsisë dhe shkalla e mos përgjigjes.</p>
6.2. Gabim i kampionimit	<p>EU-SILC është një anketë komplekse që përfshin dizenjime të ndryshme kampioni në vende të ndryshme. Në mënyrë që të harmonizohen dhe të realizohen gabime kampionimi të krahasueshme midis vendeve, Eurostat (me mbështetjen thelbësore metodologjike të Net-SILC2) ka zgjedhur të zbatojë teknikën e "linearizimit" për vlerësimin e variancës. Linearizimi është një teknikë e bazuar në përdorimin e përafrimt linear për të reduktuar statistikat jo-lineare në një formë lineare. Kjo teknikë mund të përfshijë një larmi të gjerë indikatorësh,</p>

	përfshirë treguesit EU-SILC.																																																																																						
	<p style="text-align: center;"><b>Tabla 1: Gabime standarde për disa tregues, EU-SILC 2019</b></p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Treguesit</th> <th rowspan="2">Vlera</th> <th rowspan="2">Gabimi Standart</th> <th colspan="2">Intervali i besimit në 95%</th> <th rowspan="2">CV (%)</th> </tr> <tr> <th>I poshtëm</th> <th>I sipërm</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><b>Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër</b></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr> <td>Gjithsej</td><td>23.03</td><td>0.37</td><td>22.29</td><td>23.76</td><td>1.6</td></tr> <tr> <td>Burra</td><td>22.22</td><td>0.52</td><td>21.20</td><td>23.25</td><td>2.4</td></tr> <tr> <td>Gra</td><td>23.83</td><td>0.54</td><td>22.78</td><td>24.88</td><td>2.3</td></tr> <tr> <td>Grupmosha 0-17, Gjithsej</td><td>29.73</td><td>0.87</td><td>28.03</td><td>31.44</td><td>2.9</td></tr> <tr> <td>Grupmosha 18-64, Gjithsej</td><td>22.81</td><td>0.47</td><td>21.89</td><td>23.74</td><td>2.1</td></tr> <tr> <td>Grupmosha 65+, Gjithsej</td><td>13.86</td><td>0.80</td><td>12.30</td><td>15.42</td><td>5.8</td></tr> <tr> <td><b>Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE)</b></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr> <td>Gjithsej</td><td>46.19</td><td>0.44</td><td>45.33</td><td>47.05</td><td>1.0</td></tr> <tr> <td><b>Shkalla e thellësisë së privimit material</b></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr> <td>Gjithsej</td><td>37.07</td><td>0.42</td><td>36.24</td><td>37.89</td><td>1.1</td></tr> <tr> <td><b>Shkalla e intensitetit të ulët në punësim (grupmosha 18-59 vjeç, gjithsej)</b></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr> <td>Gjithsej</td><td>12.43</td><td>0.37</td><td>11.70</td><td>13.15</td><td>3.0</td></tr> </tbody> </table>	Treguesit	Vlera	Gabimi Standart	Intervali i besimit në 95%		CV (%)	I poshtëm	I sipërm	<b>Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër</b>						Gjithsej	23.03	0.37	22.29	23.76	1.6	Burra	22.22	0.52	21.20	23.25	2.4	Gra	23.83	0.54	22.78	24.88	2.3	Grupmosha 0-17, Gjithsej	29.73	0.87	28.03	31.44	2.9	Grupmosha 18-64, Gjithsej	22.81	0.47	21.89	23.74	2.1	Grupmosha 65+, Gjithsej	13.86	0.80	12.30	15.42	5.8	<b>Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE)</b>						Gjithsej	46.19	0.44	45.33	47.05	1.0	<b>Shkalla e thellësisë së privimit material</b>						Gjithsej	37.07	0.42	36.24	37.89	1.1	<b>Shkalla e intensitetit të ulët në punësim (grupmosha 18-59 vjeç, gjithsej)</b>						Gjithsej	12.43	0.37	11.70	13.15	3.0
Treguesit	Vlera				Gabimi Standart	Intervali i besimit në 95%		CV (%)																																																																															
		I poshtëm	I sipërm																																																																																				
<b>Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër</b>																																																																																							
Gjithsej	23.03	0.37	22.29	23.76	1.6																																																																																		
Burra	22.22	0.52	21.20	23.25	2.4																																																																																		
Gra	23.83	0.54	22.78	24.88	2.3																																																																																		
Grupmosha 0-17, Gjithsej	29.73	0.87	28.03	31.44	2.9																																																																																		
Grupmosha 18-64, Gjithsej	22.81	0.47	21.89	23.74	2.1																																																																																		
Grupmosha 65+, Gjithsej	13.86	0.80	12.30	15.42	5.8																																																																																		
<b>Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE)</b>																																																																																							
Gjithsej	46.19	0.44	45.33	47.05	1.0																																																																																		
<b>Shkalla e thellësisë së privimit material</b>																																																																																							
Gjithsej	37.07	0.42	36.24	37.89	1.1																																																																																		
<b>Shkalla e intensitetit të ulët në punësim (grupmosha 18-59 vjeç, gjithsej)</b>																																																																																							
Gjithsej	12.43	0.37	11.70	13.15	3.0																																																																																		
6.2.1. Gabimet në kampionim - indikatorët	<p>Gabimet jo të kampionimit në thelb janë të 4 llojeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Gabimet e mbulimit: gabimet për shkak të divergjencave ekzistuese midis popullatës së synuar dhe kornizës bazë të kampionimit.</li> <li>2. Gabimet e matjes: gabimet që ndodhin në kohën e mbledhjes së të dhënave. Ekzistojnë një numër burimesh për këto gabime siç janë instrumenti i anketës, sistemi i informacionit, intervistuesi dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave.</li> <li>3. Gabimet e përpunimit: gabimet në proceset pas mbledhjes së të dhënave si futja e të dhënave në program, editimi dhe peshimi.</li> <li>4. Gabimet e mospërgjigjes: gabime për shkak të një përpjekje të pasuksesshme për të marrë informacionin e dëshiruar nga një njësi ose pranueshme.</li> </ol>																																																																																						
6.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Gabimi i mbulimit përfshin si mbi-mbulim, nën-mbulimin dhe klasifikimi i gabuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mbi-mbulim: ka të bëjë ose me njësi të klasifikuara gabimisht që janë në të vërtetë jashtë fushës së veprimit, ose njësi që nuk ekzistojnë në praktikë;</li> <li>• Nën-mbulimi: i referohet njësive që nuk përfshihen në kornizën e kampionimit;</li> <li>• Klasifikimi i gabuar: i referohet klasifikimit të pasaktë të njësive që i përkasin popullatës së synuar.</li> </ul> <p>Korniza e kampionimit për të dy fazat ishte e dhëna e Censit 2011.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Republika e Shqipërisë</th> <th>Adresat e zgjedhura</th> <th>Adresat e pranueshme</th> <th>Shkalla e pranueshmërisë (%)</th> </tr> <tr> <th>8,380</th> <th>7,903</th> <th>94.31%</th> </tr> </thead> <tbody> </tbody> </table>	Republika e Shqipërisë	Adresat e zgjedhura	Adresat e pranueshme	Shkalla e pranueshmërisë (%)	8,380	7,903	94.31%																																																																															
Republika e Shqipërisë	Adresat e zgjedhura		Adresat e pranueshme	Shkalla e pranueshmërisë (%)																																																																																			
	8,380	7,903	94.31%																																																																																				
6.3.1 Gabimi në mbulim	Shkalla e mbi mbulimit e SILC-2019 është 5.7% (477 NjEF nga bruto e 8380 NjEF).																																																																																						
6.3.1.1. Shkalla e mbi-mbulimit	Shkalla e mbi mbulimit e SILC-2019 është 5.7% (477 NjEF nga bruto e 8380 NjEF).																																																																																						

	Problemet kryesore	Madhësia e gabimit																																																							
		Të dhëna vjetore	• Mbi-mbulim	5.7% (DB120=23) = 477/8380 *100																																																					
			• Nën-mbulimi	N/A																																																					
6.3.1.2. Pjesa e njësive që mbulohet edhe nga anketa edhe nga burimi administrativ	Nuk aplikohet për SILC.																																																								
6.3.2. Gabimi në matje	Burimet e zakonshme të gabimeve të matjes ndodhin për shkak të papërsosmërive në pyetësor, nën-raportimit, gabimeve të bëra nga intervistuesit gjatë mbledhjes së të dhënavë, si dhe gjatë analizës së të dhënavë. SILC kryhet kryesisht nga Interviewimi Personal i Ndihmuar me Kompjuter (CAPI) i cili ndihmon mjaft kur bëhet fjalë për zvogëlimin e këtyre llojeve të gabimeve.																																																								
6.3.3. Gabimi në mos-përgjigje	Gabimet e mos përgjigjes janë gabime për shkak të një përpjekje jo të suksesshme për të marrë informacionin e dëshiruar nga një njësi e pranueshme.  Janë konsideruar dy lloje kryesore të gabimeve të mospërgjigjes: <ul style="list-style-type: none"><li>Mos-përgjigja në nivel njësie: i referohet mungesës së informacionit nga e gjithë njësia (familjet dhe / ose personat) e zgjedhur në kampion;</li><li>Mos përgjigja në nivel variabli: i referohet situatës kur një njësi model është numëruar me sukses, por jo të gjitha informacionet e kërkuar janë marrë.</li></ul>																																																								
6.3.3.1. Shkalla e mospërgjigjes së njësive	Të dhënat e vitit 2019	<table border="1"><thead><tr><th colspan="2">Norma e adresave të kontakuara</th><th colspan="2">Interviewat e familjeve të plotësuara</th><th colspan="2">Interviewat individuale të plotësuar</th><th colspan="2">Norma e mospërgjigjës së familjeve</th><th colspan="2">Norma e mospërgjigje s së individit</th><th colspan="2">Norma e përgjithëshme e mospërgjigjës së individëve</th></tr><tr><th colspan="2">(Ra)*</th><th colspan="2">(Rh)*</th><th colspan="2">(Rp)*</th><th colspan="2">(NRh)*</th><th colspan="2">(NRp)*</th><th colspan="2">(NRp)*</th></tr><tr><th>A*</th><th>B*</th><th>A*</th><th>B*</th><th>A*</th><th>B*</th><th>A*</th><th>B*</th><th>A*</th><th>B*</th><th>A*</th><th>B*</th></tr></thead><tbody><tr><td>99.6</td><td>99.6</td><td>91.6</td><td>91.6</td><td>100.0</td><td>100.0</td><td>8.8</td><td>8.8</td><td>0.0</td><td>0.0</td><td>8.8</td><td>8.8</td></tr></tbody></table>								Norma e adresave të kontakuara		Interviewat e familjeve të plotësuara		Interviewat individuale të plotësuar		Norma e mospërgjigjës së familjeve		Norma e mospërgjigje s së individit		Norma e përgjithëshme e mospërgjigjës së individëve		(Ra)*		(Rh)*		(Rp)*		(NRh)*		(NRp)*		(NRp)*		A*	B*	99.6	99.6	91.6	91.6	100.0	100.0	8.8	8.8	0.0	0.0	8.8	8.8										
Norma e adresave të kontakuara		Interviewat e familjeve të plotësuara		Interviewat individuale të plotësuar		Norma e mospërgjigjës së familjeve		Norma e mospërgjigje s së individit		Norma e përgjithëshme e mospërgjigjës së individëve																																															
(Ra)*		(Rh)*		(Rp)*		(NRh)*		(NRp)*		(NRp)*																																															
A*	B*	A*	B*	A*	B*	A*	B*	A*	B*	A*	B*																																														
99.6	99.6	91.6	91.6	100.0	100.0	8.8	8.8	0.0	0.0	8.8	8.8																																														
	A* - Rezultatet për kampionin total, B* - Rezultatet për pjesën e re të kampionit  *= A & B janë të gjitha njësoj për 2019 në AL njësoj si për valën e parë																																																								
6.3.3.2. Mos-përgjigja në nivel variabli	Llogaritja e mos përgjigjes në nivel variabli është thelbësore për të përbushur kërkkesat precise në lidhje me botimin siç thuhet në Rregulloren e Komisionit Nr. 1982/2003. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel variabli sigurohet për variablat kryesorë të të ardhurave si në nivel familje ashtu edhe personal.  Për SILC 2019, Shkalla e mos-përgjigjes në nivel variabli për një nga treguesit kryesorë rezulton të jetë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"><li>Pensionet e pleqërisë është 0.3 %</li></ul>																																																								
6.3.4. Gabimi në procesim	Burimet e mundshme të gabimeve të përpunimit përfshijnë gabimet e futjes së të dhënavë dhe një element të gabimit njerëzor në përpunimin e rezultateve. EU-SILC mblidhet përmes metodave të ndihmuara nga kompjuteri që zvogëlojnë																																																								

	mundësinë e gabimeve të tilla përmes drejtimit automatik të pyetjeve dhe validimeve të ndërtuara.
6.3.4.1. Shkalla e Imputimit	<p>Për llogaritjen e shkallës së imputimit merret në konsideratë numri i vlerave të imputuara kundrejt numri i vlerave totale.</p> <p>i. Shkalla e imputimit (I): (Numri i vlerave të imputuara/ Numri i vlerave totale)*100;</p> <p>Numri i vlerave të imputuara përfshin: numrin e shtimeve, numrin e ndryshimeve, dhe numrin e eliminimeve.</p> <p>Për SILC 2019, Shkalla e imputimit për një nga treguesit kryesorë rezulton të jetë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Pensionet e pleqërisë është 0.46 %</li> </ul>
6.3.5. Shkalla e gabimit në modelin e parashikuar përvlerësim	Nuk aplikohet. Nuk ka asnjë model të përdorur për të parashikuar / vlerësuar rezultatet.
6.4. Rregullimi stinor	Nuk aplikohet. Nuk ka asnjë rregullim sezonal të bërë në të dhënata e mbledhura nga SILC.
6.5. Politika e rishikimit	<p>Politikat e Rishikimit të SILC bëhen në përputhje me politikën e rishikimit dhe politikën e zgjidhjes së gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë informacion referojuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#"><u>Politika e revisionimit</u></a></li> <li>• <a href="#"><u>Politika e trajtimit të gabimeve</u></a></li> </ul>
6.6. Praktika e rishikimit	<p>Të dhënata e vrojtit të SILC rishikohen kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatohet një klasifikim i ri (psh. i aktiviteteve ekonomike);</li> <li>• Ekzistojnë ndryshime metodologjike;</li> <li>• Rishikimi i peshave (burime të reja dhe / ose të përmirësuara të të dhënave, korrigjime të gabimeve).</li> </ul>
6.6.1. Rishikimi i të dhënave - madhësia mesatare	INSTAT nuk ka kryer rishikim të të dhënave të SILC 2019.
<b>7. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>	
7.1. Afatet kohore	Numri i ditëve nga dita e fundit e periudhës referuese deri në ditën e botimit (kombëtar) të rezultateve të SILC.
7.1.1. Publikimi i rezultateve fillestare	Të dhënata e SILC nuk përfshijnë publikimin e rezultatit paraprak.
7.1.2. Publikimi i rezultateve finale	Të dhënata e SILC 2019 janë publikuar 1 vit + 500 ditë pas përfundimit të periudhës së referencës. Periudha referuese e rezultateve të SILC 2019 është 31 Dhjetor 2018.
7.2. Përpikmëria	Vonesa kohore ndërmjet shpërndarjes aktuale të të dhënave dhe datës së synuar kur ato duhet të ishin dorëzuar.

<p>7.2.1 Përpikmëria - shpërndarja dhe publikimi</p>	<p>Për shkak të situatës së COVID-19 në përpunimin e të dhënave, publikimi i SILC u shty për 14 maj 2021. Si rrjedhojë, publikimi i të dhënave SILC 2019 u vonua me 172 ditë.</p> <p><b>P<sub>3</sub>=d<sub>act</sub>-d<sub>sch</sub>= 5/14/2021 – 11/23/2020</b></p> <p><b>P<sub>3</sub>=172</b></p>
--	---

## 8. Koherenca dhe kahasueshmëria

<p>8.1. Krahasueshmëria gjografike</p>	<p>Mbledhja e të dhënave, pastrimi i të dhënave dhe paraqitja e të dhënave rregullohet plotësisht nga Eurostat; kjo është bërë për të siguruar që të dhënat e SILC të janë plotësisht të krahasueshme në të gjitha vendet pjesëmarrëse.</p>
<p>8.1.1. Asimetria e pasqyrës rrjedhëse së statistikave - koeficient</p>	<p>Nuk plotësohet nga INSTAT, llogaritet nga EUROSTAT pasi të janë publikuar metadatat.</p>
<p>8.2. Krahasueshmëria kohore</p>	<p>Të dhënat e SILC janë mbledhur në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 2017. Në funksion të kësaj, të dhënat mund të konsiderohen të krahasueshme ose të pajtueshme me kalimin e kohës.</p>
<p>8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme</p>	<p>Të dhënat e SILC mund të konsiderohen të krahasueshme ose të pajtueshme me kalimin e kohës. Seritë kohore të krahasueshme ekzistojnë nga 2017 në 2019.</p> <p>CC2 = Jfundit-Jfillimit + 1 = 3 vjet.</p>
<p>8.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave</p>	<p>SILC ndjek standartet ndërkontaktore: ISCO, NACE, ISCED, Shkalla e urbanizimit dhe Manuali i Canberra Group për statistikat e të ardhurave të familjeve.</p> <p>Grupet e peshave të disponueshme në të dhënat mikro të SILC janë marrë duke përdorur teknikat e kalibrimit të cilat sigurojnë koherencën themelore të vlerësimeve të marra nga të dhënat mikro të SILC dhe numërimet demografike.</p> <p>Analiza e mëtejshme e koherencës me anketat e tjera si Anketa e Forcës së Punës, Anketa e Buxhetit të Familjeve ose statistika të tjera si Llogaritë Kombëtare dhe Llogaritë e Mbrojtjes Sociale janë bërë. Këto teste sigurojnë që të dhënat që paraqiten bien në përputhje me vlerat totale të siguruar nga këto burime, duke siguruar kështu koherencën në të gjithë.</p> <p>Të dhënat e SILC që lidhen me përfitimet sociale si pensionet e pleqërisë, pensionet familjare si dhe kategori të tjera benefitesh sociale krahasonët me të dhënat administrative të disponuara nga institucionet shtetërore.</p>
<p>8.4. Koherenca e të dhënave me frekuencat e ndryshme mbledhjeje</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>

8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare	Kur analizohen të dhënat e vitit-cross-sectional të SILC, shifrat e llogarive kombëtare përdoren si standarde dhe shërbejnë si kontolle gjatë proçesit të pastrimit të të dhënave.
8.6. Koherenca e brendshme	Të dhënat e SILC janë të dhëna panel ku $\frac{3}{4}$ e kampionit përsëriten nga viti i kaluar dhe vetëm $\frac{1}{4}$ e kampionit është e re. Për këtë arsy, duke u bazuar gjithashtu dhe në rekomandimet e EUROSTAT kontrollohet në mënyrë të përhershme konsistencë e të dhënave ndër vite. Kështu të dhënat e vitit 2019 janë të krahasueshme dhe konsistente me vitet 2017, 2018.
<b>9. Aksesi në të dhëna dhe qartësia</b>	
9.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë: shpërndarja e të ardhurave, varfëria dhe përfshirja sociale. Formati i njoftimit për shtyp ka ndryshuar; Ajo përcaktohet nga sektori i botimeve, i cili përcakton edhe datën e botimit. Njoftimi për shtyp i SILC publikohet në internet në faqen zyrtare të INSTAT.
9.2. Publikime	Përdoruesit mund të gjejnë rezultatet e SILC 2019 të botuara në faqen e internetit të INSTAT: • <a href="#">Të ardhurat dhe kushtet e jetesës në Shqipëri</a>
9.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Të dhënat e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës gjenden në format Excel ku treguesit kryesorë jepen të detajuar sipas grupmoshës dhe gjinisë. Tabelat gjinden në linkun si vijon: <a href="#">Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ)</a>
9.3.1. Tabelat me të dhëna - Konsultimet	Klikimet (Page Views) në lidhje me të dhënat e “Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës” për vitin 2020 janë rreth 6,068 klikime.
9.4. Aksesi në të dhënat mikro	Si rezultat i ruajtjes së konfidencialitetit, të dhënat e SILC nuk janë në dispozicion në nivelin mikro. Të dhënat e përbledhura janë lloji i vetëm i të dhënave që u ofrohen përdoruesve të jashtëm.
9.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike përmes një seksioni të dedikuar për kontakte në lidhjen vijuese: <a href="#">Kontakt</a>
9.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër i përkufizimeve, koncepteve kryesore dhe shpjegimeve metodologjike për përdoruesit është botuar në njoftimin për shtyp dhe botimet. Kur është e nevojshme, informacion shpeshtë i sigurohet përdoruesve të brendshëm. Në faqen zyrtare të internetit të INSTAT ka një seksion në lidhje me <a href="#">Metodologjinë</a> e vrojtimit.
9.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Nivelit të Jetës dokumenton të gjithë proçesin e punës dhe procedurat e SILC për qëllime të brendshme.

9.7.1. Shkalla e plotësisë së metadatave	Nuk plotësohet nga INSTAT, llogaritet nga EUROSTAT.										
9.7.2. Metadata - Konsultimet	Nuk plotësohet nga INSTAT, llogaritet nga EUROSTAT pasi të jetë publikuar metadata.										
10. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Kohëzgjatja mesatare e intervistës në 2019 për familje u vlerësua në 38 minuta</p> <p>Numri i stafit të përfshirë për SILC:</p> <table> <tbody> <tr> <td>• Gjithsej</td> <td>48 punonjës</td> </tr> <tr> <td>1. Stafi Qendorr</td> <td>2 punonjës</td> </tr> <tr> <td>2. Intervistuesit</td> <td>44 punonjës</td> </tr> <tr> <td>3. Kontrolluesit</td> <td>2 punonjës</td> </tr> <tr> <td>4. Operatorët</td> <td>0 punonjës</td> </tr> </tbody> </table> <p>Mbledhja e të dhënave SILC kryhet duke përdorur metodën e intervistimit personal të ndihmuar nga kompjuteri (CAPI).</p> <p>Pyetësori është përfshirë në formatin CAPI dhe janë përfshirë gjithashtu rregulla logjike në pyetje. Janë zbatuar një seri validimesh që paralajmërojnë intervistuesit përmospërputhje gjatë mbledhjes së të dhënave. Kjo metodë ka shumë përparësi pasi rezulton në kohëzgjatje më të shkurtër të intervistës dhe në zvogëlimin e gabimeve të futjes së të dhënave gjatë punës në terren.</p>	• Gjithsej	48 punonjës	1. Stafi Qendorr	2 punonjës	2. Intervistuesit	44 punonjës	3. Kontrolluesit	2 punonjës	4. Operatorët	0 punonjës
• Gjithsej	48 punonjës										
1. Stafi Qendorr	2 punonjës										
2. Intervistuesit	44 punonjës										
3. Kontrolluesit	2 punonjës										
4. Operatorët	0 punonjës										
<b>11. Konfidencialiteti</b>											
11.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga INSTAT konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe kërkime shkencore në përputhje me <a href="#">Ligin Nr.17/2018 "Për Statistikat Zyrtare"</a> , si dhe <a href="#">Ligin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale"</a> . Neni 31 i Ligjit për Statistikat Zyrtare, përcakton qartë se i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose publikohet vetëm në tabelë përbledhëse, përfshirë së mos identifikuar njësinë burimore të informacionit.										
11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësise statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</li> <li>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</li> </ul> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesi, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikoohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë</p>										

	shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë dhe përcaktojë: në çfarë nivel detajimi mund të publikohen dhe shpërndahen këto të dhëna, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i njësisë statistikore të vrojtuara të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
<b>12. Komente</b>	
<b>Aneks</b>	